

DHJETOR 2022 | Nr. 22



BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

ILD JU URON GËZUAR VITIN E RI 2023!





ILD, KLGJ E KLP BASHKOHEN NË FESTË ME FËMIJËT E SHTËPISË SË FOSHNJES

Ekipet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë u

bënë bashkë këtë fundviti për të gëzuar vogëlushët e Shtëpisë së Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” në Tiranë.





Drejtuesit e tre institucioneve kaluan çaste emocionuese e festive me fëmijët e kësaj qendre dhe u mikpritën nga drejtoresha znj. Orjeta Metaj dhe ekipi i saj.





TAKIMI I FUNDVITIT ME GAZETARËT

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani zhvilloi takimin e fundvitit me gazetarë që mbulojnë veprimtarinë e ILD-së e që kanë qenë pjesë e komunikimeve me institucionin gjatë vitit 2022.





Risi e këtij takimi ishte prania e inspektorëve të ILD-së, për një panoramë sa më të plotë të institucionit si dhe komunikimi i lirshëm përmes shkëmbimit reciprok të ideve e sugjerimeve, si një ndihmesë e çmuar për punën e secilit e padyshim për një informim sa më të mirë të publikut.



SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



Gjatë asistimit të ankuesve

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut.

Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankesuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

*Gjatë muajit **Dhjetor 2022**, Sektori i Ndhmës Juridike dhe Ankesave ka pritur **22 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe **15 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.*



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Dhjetor**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **7 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

DHJETORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Dhjetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **62 ankesa**, **60** nga të cilat janë paraqitur nga qytetarët dhe **2 ankesa** nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Dhjetor** 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

15 vendime verifikimi, nga të cilat:

- 9 vendime verifikimi (Praktika të ILD-së);
- 6 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME DISIPLINORE

- 4 vendime për fillim hetimi disiplinor për 4 magjistratë
- 1 kërkesë për procedim disiplinor për 1 magjistratë

ARKIVIME

92 vendime arkivimi nga 123 praktika të shqyrtuara:

- 39 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD);
- 30 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);

23 vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat :

- 4 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- 19 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD).

SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Dhjetor**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për 50 ankues, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre.

Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



ANKETA- DUAM MENDIMIN TUAJ PËR ILD-NË

Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË MERR PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË RESIJ

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Rrjetit European të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), ku ILD është pjesë prej një viti, me statusin e vëzhguesit mes institucioneve homologe të vendeve anëtarë të BE-së, konkretisht Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë, Francë që ka presidencën e radhës së RESIJ, Komisioni Hetimor Frankofon pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Belgjikë, Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Gjyqësor, Bullgari, Inspektimi i Përgjithshëm i Drejtësisë i Ministrisë së

Drejtësisë, Itali, Shërbimi i Inspektimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Spanjë, Këshilli i Lartë i Magjistraturës, Portugali, Inspektimi Gjyqësor, Rumani.

Në Asamblenë e përgjithshme të RESIJ që u mbajt në Bruksel e u mikprit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë të Belgjikës, anëtarët e rrjetit diskutuan mbi raportin e punës së bërë gjatë vitit 2022 dhe programin për vitin 2023. Ata paraqitën edhe natyrën e tipologjinë e punës së secilit shërbim inspektimi.

Në Asamblenë e përgjithshme të RESIJ që u mbajt në Bruksel e u mikprit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë të Belgjikës, anëtarët e rrjetit diskutuan mbi raportin e punës së bërë gjatë vitit 2022 dhe programin për vitin 2023.

Ata paraqitën edhe natyrën e tipologjinë e punës së secilit shërbim inspektimi.



“Duke vepruar kështu, të gjithë ne do të kontribuojmë në funksionimin e duhur të organeve të sistemit të drejtësisë dhe në përmirësimin e cilësisë së sistemit të drejtësisë, duke arritur qëllimin tonë të përbashkët.”, u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë.



“Edhe pse nuk ka një model unik dhe të vetëm, që të zbatohet për të gjitha vendet njësoj, për shkak të formës së organizmit dhe funksionimit, tha z. Metani, në thelb të veprimtarisë së shërbimeve të inspektimit të drejtësisë duhet të qëndrojë respektimi i parimit të ndarjes së pushteteve. Sepse sot pothuajse të gjitha vendet tona përballen me një sfidë të madhe! Si të ndërtojnë një sistem drejtësie eficient dhe të pavarur!”

Gjatë prezantimit të tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani bëri panoramën krahasimore të të gjitha shërbimeve të rrjetit dhe paraqiti ide mbi fokusin e RESIJ në ardhmen dhe bashkëpunimin me institucione të Bashkimit Evropian.

“Edhe pse nuk ka një model unik dhe të vetëm, që të zbatohet për të gjitha vendet njësoj, për shkak të formës së organizmit dhe funksionimit, tha z. Metani, në thelb të veprimtarisë së shërbimeve të inspektimit të drejtësisë duhet të qëndrojë respektimi i parimit të ndarjes së pushteteve. Sepse sot pothuajse të gjitha vendet tona përballen me një sfidë të madhe! Si të ndërtojnë një sistem drejtësie eficient dhe të pavarur! Si t’i bëjë magjistratët më të drejtë dhe më të paanshëm, si dhe si të forcojnë integritetin e tyre! Në këtë proces një kontribut të rëndësishëm kemi edhe ne, shërbimet e inspektimit.”





Duke nënvizuar rëndësinë e vijimit të bashkëpunimit, përmes shkëmbimit të eksperiencave, unifikimit të praktikave më të standardet e demokracisë dhe drejtës, krijimit të administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit, shkëmbimit të ndërmjet z. Metani tha se nga RESIJ kërkohet një strategji e frymëzimin e dialogut, promovimin e konsultimit,

ndërtimin e një konsensusi dhe bashkëpunimi me qëllim angazhimin dhe aktorëve të ndryshëm, si ato të krijuara nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës, ashtu edhe të Bashkimit Evropian.

“Duke vepruar kështu, të gjithë ne do të kontribuojmë në funksionimin e organeve të sistemit të drejtësisë dhe në përmirësimin e cilësisë së drejtësisë, duke arritur qëllimin tonë të përbashkët.”, u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë.





METANI: ITALIA ËSHTË PARTNERI NATYRAL I SHQIPËRISË NË RRUGËN DREJT BE-SË

Gjatë vizitës së punës në Romë, In- si dhe përpjekjet e Shqipërisë spektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Me- për zbatimin e reformës në drejtësi, tani zhvilloi një takim me kryetaren e bazuar në ristrukturimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese të Italisë, znj. Sil- institucioneve të saj, si pjesë e sfidës për vana Sciarra dhe anëtarët, znj. Maria Ro- konsolidimin e shtetit të së drejtës, sidomos në fazën e rëndësishme ku ka hyrë vendi, procesin e antarësimit në BE, me

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i njohu negociatat e sapo nisura me Komisionin me punën e institucionit që drejton, European, pikërisht me kapitullin 23, mbi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Silvana Sciarra shprehu vlerësimin për bashkëpunimin e ILD-së me homologët italianë dhe angazhimin e Shqipërisë në negociatat për antarësim në Bashkimin Evropian.



gjyqësorin dhe të drejtat themelore. Inspektoratin e e Përgjithshëm të Ministrisë italiane të Drejtësisë, 8 muaj më parë, formalizuar me një marrëveshje, që jetëzohet me aktivitete konkrete.”, tha z. Metani.

një proces efikas bashkëpunimi, si një mundësi e jashtëzakonshme, që institucionet tona të përshtaten me vlerat mbasi të cilat është themeluar BE-ja. Italia është partneri natyral i Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE-së dhe dukshëm bashkëpunimi ka rezultate, siç është për shembull për ILD-në, bashkëpunimi me Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese znj. Silvana Sciarra shprehu vlerësimin për bashkëpunimin e ILD-së me homologët italianë dhe angazhimin e Shqipërisë në negociatat për antarësim në Bashkimin Evropian.

“Italia është partneri natyral i Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE-së dhe dukshëm bashkëpunimi ka rezultate, siç është për shembull për ILD-në, bashkëpunimi me Inspektoratin e e Përgjithshëm të Ministrisë italiane të Drejtësisë”, tha z. Metani.

DHJETOR 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)